



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice
Kabineti i Ministres-Kancelarija Ministra-Cabinet of the Minister

Nr. 10 /2024
Datë: 15/01 2024

Në mbështetje të nenit 9, nenit 10 dhe nenit 11 të Ligjit nr. 06/L-113 për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura (GZ, nr. 7, 01 mars 2019), në bazë të nenit 11 (paragrafi 1, nën-paragrafi 1.5) të Ligjit nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 3 (paragrafi 1, nën-paragrafi 1.15.4) dhe nenin 4 të Ligjit nr. 06/L-021 për kontrollin e brendshëm të financave publike, në pajtim me nenin 7 të Rregullores nr. 01/2019 menaxhimin financiar dhe kontrollin, si dhe në përputhje me Rregulloren QRK-nr. 14/2023 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive (Shtojca 1, pika 3), Ministria e Drejtësisë, si udhëheqëse e sektorit të subjektit publik (SSP), nxjerr:

V E N D I M

Për delegimin e autorizimeve për zyrtar autorizues për menaxhimin e buxhetit, shpenzimeve dhe pasurisë

1. Ministria e Drejtësisë – Anita Kalanderi, Sekretare e Përgjithshme
2. Agjencitë Ekzekutive në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë, si në vijim:
 - 2.1 Shërbimi Korrektues i Kosovës – Ismail Dibrani, Drejtor i Përgjithshëm;
 - 2.2 Shërbimi Sprovues i Kosovës – Arsim Tahiri, Drejtor i Përgjithshëm;
 - 2.3 Instituti i Mjekësisë Ligjore – Ditor Haliti, Zv. Drejtor i Përgjithshëm;
 - 2.4 Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe Konfiskuar – Enver Krasniqi, Zv. Drejtor i Përgjithshëm;
 - 2.5 Inspektorati i Ministrisë së Drejtësisë – Muamer Bikliqi, zv. Kryeinspektor;
 - 2.6 Avokatura Shtetërore – Arsim Zuka, Zv. Avokat i Përgjithshëm Shtetëror
 - 2.7 Agjencia për Ndihmë Juridike Falas, zv. Flutura Berbati-Zena
3. Zyrtarët e përcaktuar në paragrafin 1 dhe 2 të këtij vendimi tek të cilët janë deleguar autorizimet, janë të obliguar që të veprojnë në harmoni me Ligjin përkatës mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, Ligjin përkatës të Buxhetit, Ligjin përkatës të Prokurimit dhe dispozitat tjera përkatëse dhe të delegojnë autorizimet për menaxhimin financiar dhe kontrollin zyrtarëve përkatës të tyre.

4. Zyrtarët autorizues, të cilëve ju janë deleguar autorizimet, përveç autorizimeve sipas paragrafit 3, ju delegohen të gjitha autorizimet për menaxhimin e pasurisë jo financiare sipas Rregullores nr. 02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë Jo Financiare, neni 4, (pika 1, 2, 3 dhe 4), që të menaxhojnë pasurinë jo financiare për departamentet/divizionet/sektorët/programet të cilat i udhëheqin, në të gjitha aspektet, duke filluar nga autorizimi, pranimi, dhënia në shfrytëzim, kujdesi, mbajtja e evidencës, regjistrimi, vlerësimi pas amortizimit ekonomik apo shlyerja-përveç tjetërsimi. Të gjitha veprimet, duhet të merren sipas ligjeve dhe rregulloreve të cilat janë në fuqi.
5. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.



Vendimi i dërgohet:

- Të lartpërmendurove;
- Kabinetit të Ministres;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Departamentit për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme;
- Divizionit për Buxhet dhe Financa;
- Departamentit të Prokurimit;
- Arkivit të MD-së.